

VËSHTRIM E INTERPRETIM GJUHËSOR MBI MËNYRËN E KONCEPTIMIT TË NYJËS SI PJESË LIGJËRATE

GLADIOLA DURMISHI (ELEZI)

Departament of Albanian language and literature, University of Vlora "Ismail Qemali", Albania

Email: gladiola.elezi@yahoo.it

AKTET VI, 4: 430-437, 2013

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim kemi trajtuar disa çështje që lidhen me nyjat dhe burimin e tyre. Përshkruhet dhe shpjegohet nyja e përparme dhe evolimi i saj në gjuhën shqipe, format e nyjeve të përparme tek emri dhe te mbiemri. Duke iu referuar punimeve dhe studimeve, që janë kryer më parë për çështjen e nyjave jo vetëm nga gjuhëtarët më përfaqësues të shqipes, por edhe nga gjuhëtarët e huaj. Në kuadrin e shqipes si pjesë e gjuhëve indoeuropiane jemi ndalur edhe në vendin e nyjës së përparme në shqipe në, "moshën" e saj dhe evoluimin që ka pësuar. Përfshijmë këtu edhe trajtimin e disa çështjeve të zhvillimit të formave rasore dhe kryesisht rasi me nyjë të përparme. Duke parë nyjën në të gjitha këto këndvështrime, një çështje e rëndësishme e punimit tonë është dhe problemi i nyjës si pjesë e ligjërate. Të gjitha fjalët e një gjuhe grupohen në nëpër klasa dhe nëpër kategori leksiko-gramtikore që quhen pjesë të ligjëratës. Por kufijtë që ndajnë pjesët e ndryshme të ligjëratës nuk janë të pakapërcyeshme; shpesh herë një fjalë gjatë përdorimit të saj, merr një përmbajtje leksikore dhe veçori gramatikore të ndryshme nga ato të klasës përkatëse. Në raste të tilla ajo kalon në një pjesë tjetër ligjërate. Pra duke iu referuar kritereve gramatikore për strukturën e gjuhës lind pyetja: Nyjat a mund të shihen si pjesë e ligjëratës? Çfarë vendi zënë ato?

SUMMARY

In this paper we address some issues related to the nodes and their source. Described and explained the front hub and its evolution into Albanian, nodes forms the front to the name and surname to. Reference works and studies conducted previously for the case of joints with not only by linguists but also representatives on the Albanian foreign linguists. In the context of Albanian as a part of indoeuropean languages are also in place stopping the front node in Albanian its "age" and evolution that has gone through. Well here include the treatment of some forms of development issues racial and mainly the church with front hub. By the first node in all these approaches an important issue of our paper and the problem is the node as part speech. All words of a language are grouped into classes of lexicon-grammatical categories that are grouped into part of lecture. But the boundaries that divide different parts of speech are not insurmountable: often a word during its use takes a context lexical and grammatical characteristics different from those of respective class. In such cases, it goes in another section of speech. Well grammar reference criteria for the structure of our language question. Node can be seen as part of lecture? Where are they? "Morpheme nodes are staying in the forefront of some words of forms of words. They are written separately from the word of morpheme to which belong the part of which are". Morpheme itself on the other hand is defined as the smallest unit of meaningful, which may be defined as the smallest unit of meaningful, which may differ in the composition of speech and that can be further divided into until smaller meaningful. Under this definition are nouns and morpheme is the meaningful, but a node is a part of lecture? Referring to the linguistic criterion by which to classify a word in this or that part of the lecture should be determined and meet two criteria: meaning categorial lexicon grammar and its features. Opinions expressed by linguists and studies on this issue are different and often contradictory so the problem still remains unclear. Mentioned above that there are no limits on language for the fact that language should see the evolution on this unit from the source, the place that in languages the other Balkan countries and especially in the Albanian language. Role of the anterior node and which forms, the

front emerging nodes back to the name and surname, to racist content and developing forms with the front hub, all these references to help us shed light on the issue of filing; node as part of speech.

Hyrje

Nyjat janë morfema që qëndrojnë në ballë të disa fjalëve ose formave të fjalëve të eptueshme. Ato shkruhen ndaras nga fjala ose forma së cilës i takojnë, a pjesës e së cilës janë". Nga ana tjetër, vetë morfema përcaktohet si njësi më e vogël e kuptimshme, që mund të dallohet në përbërjen e fjalës, dhe që nuk mund të ndahet më tej në njësi të tjera më të vogla të kuptimshme. Sipas këtij përkufizimi nyjat janë morfema dhe morfema është njësi e kuptueshme, por a është njësi e ligjëratës? Duke iu referuar kriterit gjuhësor sipas të cilit që një fjalë të klasifikohet në këtë apo atë pjesë të ligjëratës duhet të përcaktohet dhe të përmbushë dy kritere; kuptimi leksiko-kategorial dhe veçoritë e saj gramatikore. Mendimet e shprehura nga gjuhëtarët dhe studiuesit për këtë çështje janë të ndryshme dhe shpesh kontraktore, prandaj ende ky problem mbetet i paqartë. Përmendëm më sipër se kufijtë në gjuhë nuk egzistojnë për vetë faktin se gjuha gjithmonë evoluon, ndryshon, përsoset. Prandaj, për të përcaktuar qartë vendin që zë nyja në gjuhën shqipe, duhet ta shohim evoluimin e kësaj njësie që nga burimi, vendin që zë ajo në gjuhët e tjera ballkanike dhe veçanërisht në gjuhën shqipe. Roli i njëjës së përparme dhe në cilat nyja dalin format e përparme, nyjat e prapme tek emri e mbiemri, si dhe zhvillimin e formave rasore me nyje të përparme. Të gjitha këto referime na ndihmojnë të hedhim dritë për çështjen e parashtruar; nyja si pjesë ligjërate.

Në gjuhën shqipe ka disa njësi, si nyjat e përparme (*i, e, të, së*), të cilat nuk kanë tiparet e fjalës, prandaj është shkencërisht e pasaktë të trajtohen si njësi leksikore, pra si fjalë dhe si pjesë ligjërate. Nyjat në gjuhësinë shqipe të trashëguar janë ndarë në:

1. Nyjat prapme; (*i, u, a, t*), me të cilat ndërtohet trajta e shquar e emrave, por janë si mbaresa, kanë kuptime gramatikore (jo leksikore) dhe u ngjiten emrave pas, nuk kanë përdorim të veçuar, rrjedhimisht janë morfema ndajshtesore, pjesë e fjalës dhe jo fjalë më vete.

2. Nyjat e përparme ku bëjnë pjesë:

a) Nyjat e mbiemrave, si: (*i mirë, e kuqe, së larti*), nyjat e disa emrave, si: (*i sëmuri, e hënë, të menduarit*), nyja e disa përemrave, si: (*i cili, e saj, të tyre*), nyjat e numërorëve rreshtorë, si: (*i pari, e dyta, të pestë*). Të gjitha këto nyja janë pjesë të fjalëve përkatëse, shërbejnë për të dalluar kategoritë leksiko-gramatikore të gjinisë, numrit, rasës, njësoj si nyjat e prapme dhe nuk kanë përdorim të paravarur.

b) Nyjat e emrave në rasën gjinore (*i djalit, e vajzës, të malit, të fushës*) që janë pjesë e trajtës së fjalëve (e rasës gjinore), jo vetëm e fjalëve, pra shërbejnë për të ndërtuar një trajtë të caktuar fjale.

c) Të ashtuquajturat "nyja pronore" (*i ati, e ëma, të vëllait, së motrës*), kanë kuptim pronësie, mbartin kuptim leksikor të trajtave të plota përemërore (*i ati = ati i tij / i saj, e ëma = ëma e tij/e saj*) edhe nëse ato vijnë nga nyja e këtyre trajtave përemërore.

Çështje të cilat trajtohen në punim;

1. Nyjat dhe burimi i tyre

2. Nyja e përparme

3. Format e nyjave të përparme tek emri dhe tek mbiemri

4. Nyja e përparme në gjuhët ballkanike dhe në gjuhën shqipe

5. Huazimet e shqipes nga gjuhë të tjera

1. Nyjat dhe burimi i tyre

Gjuha shqipe prej kohësh ka pasur një sistem të tillë lakimi; lakimi i shquar -lakimi i pashquar. Lakimi i shquar është zhvilluar pas lakimit të pashquar dhe ka përfutur mjetet e veta të shprehjes që janë quajtur nyja shquese. Ndryshe nga shumë gjuhë të tjera, gjuha shqipe krahas nyjave shquese që i prapangjiten emrit me funksionin e caktuesisë, ka dhe forma të tjera nyjore të paravendosura, por edhe të prapangjitura, pra ky sistem nyjash është jo vetëm original, por edhe i ndërlikuar. Nyjat shquese e kanë burimin te përemrat dëftorë të përdorur me kuptim referues pranë emrave të

përgjithshëm. P.sh.: ...pashë një shkëmb; ai shkëmb, përemri *ai* del si fjalë referuese e emrit *shkëmb*. Përemri *ai* në fillim është shoqëruar me emrin *shkëmb*, por më vonë ripërsëritja e emrit ka qenë e panevojshme. Struktura e re ...*një shkëmb - ai*, lejonte mundësinë e lidhjes së drejtëpërdrejtë të emrit me përemrin dëftor referues. Kështu, përemrat dëftorë e kanë humbur kuptimin e tyre të mëvetësishëm, kanë humbur theksin dhe janë kthyer në një mjet gramatikor të emrit, duke iu prapangjitur atij. Emri i përgjithshëm i pajisur tani me këtë mjet emërton një send ose sende të veçanta, të njohura nga bashkëbiseduesit.

Nyja shquese u zhvillua në fillim tek emrat e përgjithshëm, por me kalimin e kohës ajo u shtri edhe tek emrat e përveçëm, nyja e pasme; Agron-i. Duke qenë se paradigma e lakimit të pashquar ishte reduktuar mjaft, lindi nevoja e përfitimit të nyjës jo shquese si një mjet normal i kundërvënies. Nyja joshquese burimin e ka te numërori themelor *një*. Ky numëror ka kaluar në një jo të drejtëpërdrejtë, por nëpërmjet përdorimit të saj si përemër i pacaktuar. Si një jo shquese *një-ja* ka humbur kuptimin leksikor dhe theksin. Nyja *një* sot përdoret vetëm e ngurosur, por tek autorët e vjetër ajo del: Buzuku;...majë *njëi* mali, si një gjinore e zgjeruar. Përcaktimi i funksionit burimor të kësaj njësie kufizohet mes përdorimit të saj si numëror dhe si përemër i pacaktuar. Përdorimi i saj me funksionin e nyjës joshquese është relativisht i vonë. Ai është përfutur pas lindjes së nyjës jo shquese, është relativisht i vonë. Ai është përfutur pas lindjes së nyjës jo shquese, të kategorisë gramatikore të shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe, prej përemrit të pacaktuar *një* për të shprehur më mirë kuptimin e pacaktuar në kundërvënien me kuptimin e caktuar të një emri të përgjithshëm të përdorur në mënyrë të individualizuar (me një shquese; njeriu - një njeri) (Demiraj, 302 v).

Në lidhje me raportin kronologjik numëror-përemër i pacaktuar, të dhënat e gjuhës shqipe dhe të indoeuropianistikës tregojnë për shfaqjen më të hershme të funksionit numëror të njësisë *një*. Funksioni i përemrit të pacaktuar vjen si

përdorim i numërorit *një* me një kuptim të pacaktuar (Demiraj, 525). Përdorimi i njësisë si një përemër i pacaktuar u takon periudhave të vona të gjuhëve të ndryshme indoeuropiane dhe nuk ka lidhje me bazat e gjuhëve të ndryshme indoeuropiane dhe me bazat përemërore indoeuropiane, prej së cilave është përfutur ky numëror me këto gjuhë (Burgman Grundri 11/2, 348).

2. Nyjat e përparme

Burimi i nyjave të përparme është një nga problemet më të ndërlikuara të gjuhës shqipe. Duke i krahasuar me nyjat e prapme, të cilat kanë si funksion caktuesinë, nyjat e përparme janë quajtur nyja vetëm për shkak të ngjashmërisë formale dhe të lidhjeve që kanë me përemrat dëftorë.

Nyjat e përparme kanë këto funksione;

Në funksionin e një morfeme fjalëformuese ose trajtëformuese;

1. Te mbiemrat e nyjshëm; *i gjatë, i hapur, i mirë* etj.

2. Te emrat asnjans: *të folurit, të ecurit* etj.

3. Te përemra; *i cili, të tillë, të gjithë, i tij* etj.

4. Te gjinorja e emrave; *i malit, i djalit* etj. Në funksion të një pronori të vetës së tretë, *i biri, i ati* etj. Në funksion caktues; *të dy, të tre* etj. Si pjesë e temës në emrat e ditëve të javës; *e hënë, e martë* etj.

Funksionet e nyjave të përparme ndryshojnë nga ai i nyjave të prapme. Funksionet e nyjave të përparme ndryshojnë edhe brendapërbrenda vetë nyjave të përparme, kjo e bën të vështirë shpjegimin e burimit të tyre. Cilat nyje janë pasuese të përemrave dëftorë anaforikë? A janë të gjitha nyjat zhvillime të drejtëpërdrejta të përemrave dëftorë anaforikë? Cilat nyja janë më të vjetra në gjuhën shqipe, nyjat e përparme apo ato të prapme? Shumë gjuhëtarë duke parë se nyjat shquese në shumicën e gjuhëve europiane qëndrojnë para emrave, mendojnë se në të kaluarën nyja shquese në gjuhën shqipe ka qenë e paravendosur.

Disa mendime të gjuhëtarëve janë:

H. Pedersen, burimin e nyjës së përparme e sheh te përsëritja e nyjës së përparme në sintagmën

pus i thellë. Nyja e përparme e mbiemrit u tërhoq nga emri paraprijës dhe u shfaq pastaj te *pus i thellë* > *pusi thellë* > *pusi i thellë*.

B. Bokshi i përmbahet pikëpamjes se renditja M+A2+E ku (M=mbiemër, A2 = njëjshquese, E = emër). Në të kaluarën ka qenë renditje e detyrueshme. Ai shton se nyja shquese do të aglutinohej në shqipe pas një periudhe relativisht të gjatë pasi të kalonte në postpozicion. Pra, kjo hipotezë është kundërshtuar kohët e fundit nga E. Çabej, që në kundërshtim me mendimin e përgjithshëm, arrin në bindjen se “postpozicioni i artikullit në shqipen, është më i vjetër se pozicioni proklitik dhe se ky i fundit ka rrjedhur prej atij në ngërthin e fjalisë me anë të një përsëritjeje”. Pavarësisht nga pikëpamjet që janë dhënë për vjetërsinë e nyjave të prapme dhe të përparme, burimi fillestar është një përemër dëftor anaforik.

Për burimin e nyjave të përparme te mbiemrat ka dy mendime kryesore:

1. Ato burojnë nga njëra-tjetra.
2. Ato janë zhvillime të pavarura.

Nyja para emërore themelore: *të dy, të tre*.

Në shqipen e sotme funksioni i njëjsh së përparme të numërorit themelor *të dy, të tre* është i ngjashëm me atë të njëjsh shquese të emrit, por jo i njëjtë me të. Për burimin e tyre ka mendime të ndryshme; si: Çabej, i cili vëren se për këtë njëjsh kuptimi i tërësisë, ka kaluar në kuptimin e caktuesisë. Sipas Çabejt *të dy* do të thotë “që të dy” dhe pastaj “ata të dy”. Sipas Demiraj e sotmja “të dy” mund të ketë dalë nga më e hershmja “to dy” nga “ata të dy”, reduktohet në “ta dy”, *ta* në *të, ta dy>të dy*. Duket se kjo njëjsh buron nga përdorimi i një dëftori anaforik që i paraprin numërorit (ta dy/to dy).

Nyja para emrave të farefnisës; *i biri, e bija*.

Riza përcakton se nyja e përparme ka ruajtur vlerën e saj të dikurshme. Demiraj ka mendimin se zanafilla e kësaj nyje me vlerë pronori sot për sot është historikisht e paqartë. Kurse Bokshi, burimin e kësaj nyje e kërkon te sintagmat *i ti(j) bir, e sa(j) amë*, të cilat pas krijimit të pronorëve *im bir, yt bir* “paralajmëronte”, kur duhej përdorur me kuptimin e pronësisë. Prandaj *im bir, yt bir*, sintagmat *i tij bir, e saj amë*, mbeten në

strukturën e vjetër (i), (e) si nyja të gjinore, (i tij), (e saj). Por njësia e re leksikore (i bir) nuk jepte kuptimin e pronësisë, prandaj në vetën e tretë u shoqërua dhe me njëjsh shquese *i bir-i*.

Nyja para emrave të ditëve të javës; *e hënë, e martë, e mërkurë*.

Sipas Çabejt emrat e ditëve të javës kanë burimin e njëjsh në sintagmat; *ditën e hënë; ditën e martë*. Në këto sintagma si gjymtyrë e parë ka shërbyer emri *ditë*, e cila është në përputhje edhe me formën e njëjsh (e) që i paraprin këta emra. Gjymtyra e dytë ruan tiparet mbiemërore, ajo ndyshon si gjithë mbiemrat e njëjshëm (*dita e hënë, ditës së hënë* etj.,). Duket se mbaresa rasore *-e* dhe *-i* (ditë e hënë-ë, ditë e martë-ë) duke humbur funksionet morfologjike u errësua në *-ë* tek e *hënë-ë, e martë-ë, e mërkurë-ë, e shtunë-ë, e dielë*, kurse tek e *enjtë-e* dhe *premtë-e* fundorja mbeti e sepse përputhej me mbaresën e gjinore së pashquar njëjsh-e (e enjtë-e>e enjtëe e enjtë, e premtë-e> e premtëe, e premtë) Zhvillimi i formave të emrave të ditëve të javës ka ndjekur këto shkallë; gjinore e emrit në të pashquarën njëjsh, gjinore e emëruar > mbiemër i emëruar.

3. Format e nyjeve të prapme dhe të përparme tek emri dhe mbiemri

Pavarësisht nga mendimet e ndryshme për vjetërsinë e tyre, burimi fillestar i nyjave të prapme dhe të përparme ka qenë një përemër dëftorë anaforik. Për lidhjen historike të tyre dëshmojnë format e njëjta, që kanë ato midis tyre dhe me përemrat dëftorë.

P.sh.: bëjmë një krahasim midis rasave:

Numri njëjsh -gjinia mashkullore

Rasa Përemri dëftorë

Nyja e prapme Nyja e përparme

ai (lis-i, ahu) (i gjatë)

Em. a-i -i,-u i

Gj. a-ti -t të

Dh. a-ti-j -t të

Ka. a-të -në/-n të, e

Rr. a-si -t së, të

Duke krahasuar vetëm format e mirëfillta përemërore, përveç *a-së* dhe *j-së*, me format përkatëse të nyjave të përparme dhe të prapme, forma e emërores së dëftorit të mirëfilltë (i)

përkon plotësisht me formën e nyjës së prapme dhe të përparme. Në rasën gjinore forma e dëftorit del (-ti) e cila duke qenë e patheksuar është reduktuar më tej në (të), siç del te nyja e përparme, kurse tek nyja e prapme (-t) zanorja e patheksuar tani në fund të emrit, ka rënë për arsye fonetike. Në rasën kallëzore forma e dëftorit del (-të), e njëjta formë del dhe si nyje e përparme (te), por si nyjë e prapme del me një përbërje krejt të ndryshme fonetike *-në /-n*. Edhe nyja e prapme në krye të herës ka qenë (-të), por duke u bashkuar me mbaresën e kallëzores së pashquar të emrit (-n), nëpër disa shkallë ka dhënë një përfundim tjerër *lis-n+t> lis-ndë> lis-nnë> lis-në*. Trajta (e), e cila del si nyjë e përparme, kur emri prijës është në trajtë të shquar, është dytësore. Në rasën rrjedhore forma e hershme e dëftorit (-si), e patheksuar në funksion të nyjës, ka përfunduar në (se), e cila dokumentohet nga fazat më të hershme si nyjë e përparme (Budi; perj gurit (së) Bardhë), por sot si nyjë e prapme del në formën (të) nën ndikimin e trajtës së dhanores. Trajtën (të) e gjejmë edhe si nyjë të përparme në përdorime të kushtëzuara (Likaj, 66).

4. Nyja e përparme në gjuhën shqipe dhe në gjuhët ballkanike

Prapavendosja e nyjës shquese

1. Prapavendosja e nyjës shquese është ndër ballkanizmat më tipike edhe pse dihet që ndeshet në gjuhë të tjera indoeuropiane jashtë Ballkanit, si p.sh.: në gjuhën armenishte, në gjuhët skandinave, madje edhe në gjuhë të tjera indoeuropiane. Kjo nyjë ndeshet edhe në gjuhë të ndryshme ballkanike, që u përkasin grupeve të ndryshme të familjes indoevropiane, siç janë edhe shqipja, rumanishtja. Nyja shquese është e paravendosur dhe gjuhët sllave në përgjithësi nuk kanë zhvilluar ndonjë nyjë shquese. Në gjuhët ballkanike nyja shquese e prapavendosur, është përfutur nga evolucioni i përemrave dëftorë përkatës, madje në shqipe e në rumanishte nyja shquese e prapavendosur i ka ruajtur në njëfarë mase edhe format rasore gjegjëse të përemrave dëftorë përkatës. Në bullgarishte e në maqedonishte nyja shquese e prapavendosur del

sot në një formë rasore të vetme. Prapavendosja e nyjës shquese në gjuhët e ballkanit ka tërhequr vëmendjen e gjuhëtarëve si: J. Kopitar, Milkoshiçi, Senfeldi, Çabej, Georgevi, Bokshi etj. Ata që janë marrë me studimin krahasues të nyjës së prapme në gjuhët ballkanike, kanë shprehur mendimin e tyre lidhur me burimin e kësaj dukurie ballkanike;

a) Hipoteza e substratit - burimi i prapavendosjes së nyjës shquese duhet kërkuar në gjuhët e vjetra të ballkanit.

b) Hipoteza e ndikimit të latinishtes vulgare, nga Reichenkroni-i.

c) Hipoteza e ndikimit të gjuhës shqipe. Krijimi i nyjës së përparme shquese në rumanishten është kryer nën ndikimin e gjuhës shqipe. Këtë mendim e mbron edhe Bokshi.

d) Hipoteza e ndikimit sllav e shprehur nga Piotrovski. Për ndikim të bullgarishtes mbi rumanishten nën prapavendosjen e nyjës shquese janë shprehur edhe Miljetiçi (Sandfeld; 1930, 167; Bokshi: 1984, 124).

e) Hipoteza e ndikimit grek, greqishtja ka ndikuar në vetë krijimin e nyjës shquese në gjuhët e ballkanit, por jo në prapavendosjen e saj (Bokshi:1984, 39).

f) Hipoteza e një zhvillimi të pavarur; prapavendosja e nyjës shquese është një zhvillim i pavarur jo vetëm në gjuhën shqipe dhe në rumanishte, por edhe në bullgarishte dhe në maqedonishte (Demiraj 1986: 336; 1988: 59).

Siç del edhe nga përmbledhja sot nuk ka mendim të përbashkët, për burimin e kësaj dukurie në gjuhët e ballkanit. Me siguri, ajo duhet të jetë e hershme. Po t'i referohemi faktit se në gjuhët sllave prapavendosja e nyjës shquese dokumentohet më vonë se në gjuhën shqipe dhe rumanishte, burimi sllav duhet përjashtuar. Dhe burimi grek duhet përjashtuar sepse në greqishte nyja shquese është shumë e vjetër, por ajo del në krye të herës e paravendosur. Dhe nëse do të kërkojmë te shqipja dhe te rumanishtja burimin e kësaj dukurie, ajo paraqitet mjaft e vështirë. Më parë duhet të sqarohet se sa e vjetër është prapavendosja e nyjës shquese në gjuhët ballkanike, dhe në cilat nga këto gjuhë treguesi i shquarsisë ka qenë më përpara i paravendosur.

Në gjuhët sllave të ballkanit nyja e prapavendosur nuk duhet të jetë shumë e hershme. Gjurmët e një nyje të prapavendosur ndeshen në shkrimet e vjetra “maqedonase” qysh në shek. XVIII. Gjithashtu, pohoet prania e nyjës shquese në rumanishten e përbashkët pas shek.VII, ku vihet re organizimi i fleksionit emëror. Përkimi mes degëve të ndryshme të rumanishtes tregon se zhvillimi i nyjës ka qenë fakt i kryer para shek. X. Edhe në gjuhën shqipe nyja e prapme është e një vjetërsie më të madhe se dokumenti i shek XVI, se shpërnguljet e arbëreshëve në Itali dhe në Greqi. Duhet të kemi parasysh se format rasore të nyjave të prapme paraqiten me të njëjtin evolucion fonetik dhe në shkrimet më të vjetra përkëtej dhe përtej Adriatikut, si dhe në të folmet e arvanitasve në Greqi. Duhet të kemi parasysh se procesi i përngjitjes së formave rasore të nyjave të prapme në format rasore të emrit, nis para se të pushonte së vepruari dukuria e rotacizmit /-n/>/-r/ në të folmet jugore të shqipes (*zani* → *zër-i*), pra para shek VII-VIII -të e.r. Prandaj, prapavendosja e nyjës shquese në gjuhën shqipe duhet të jetë shumë e hershme (Demiraj). Kjo dukuri është një fakt gjuhësor i vetë shqipes apo kjo e ka trashëguar atë nga “nënë”e saj (La Piana 1939: 129). Sipas Rrechehenkron-it (1963: 99) *“prapavendosja e nyjës shquese në rumanishte, shqipe dhe bullgarishte është si pasojë e faktit se në këto gjuhë ka mbizotëruar kurba zbritëse e të folutit.”* Nga çfarë u vu në dukje del se: çështja e burimit të prapavendosjes së nyjës shquese në gjuhët ballkanike mbetet e pazgjidhur bindshëm. Kështu hipoteza e burimit sllav nuk gjen mbështetje. Në shqipe e në rumanishte nyja shquese e prapavendosur është më e hershme se në maqedonishte e bullgarishte. Pra lindja e nyjës shquese në këto dy gjuhë sllave jugore, dhe mungesës së saj në gjuhët e tjera sllave, mund të shpjegohet si një zhvillim i brendshëm i atyre gjuhëve, por në ndikimin e gjuhëve fqinje si shqipja e rumanishtja, ku nyja e prapme shquese ishte zhvilluar më herët. Kjo është një shfaqje e ballkanizmit të bullgarishtes nëpërmjet krijimit të kundërvënies trajtë e pashquar -trajtë e shquar e emrave. Kjo kundërvënie është krijuar nëpërmjet

përemrave dëftorë përkatës. Përemri dëftor anaforik, duke u përdorur si mjet gramatikor, do të humbiste theksimin dhe prandaj u përdor si një fjalëz enklitike, që iu prapangjit emrit. Sipas rregullsisë së sistemit fonetik-sintaksor të gjuhëve sllave, pritej që ky mjet gramatikor të përdorej herë pas here para emrit në varësi të pozicionit të këtij në fillim apo në mes të fjalisë. Hipoteza e ndikimit latin mbështetet në faktin e njohur që sundimi i gjatë romak në ballkan ka lënë gjurmë të shumta në gjuhët ballkanike. Në rumanishte që është një gjuhë romane, nyja shquese duhet të dalë e paravendosur, por në shqipe dhe në rumanishte ajo del e prapavendosur dhe mbrojtësit e kësaj hipoteze duhet ta shpjegojnë arsyen pse nyja shquese në shqipe e në rumanishte del e prapavendosur. Megjithatë deri sot nuk është vërtetuar që nyja si tregues gramatikor të ketë marrë një zhvillim të tillë në latinishten vulgare. Edhe hipoteza e ndikimit grek, se *“në shfaqjen e nyjës, nyja shquese në gjuhët e ballkanit nuk del e mbështetur, sepse në greqishte nyja që në krye të herës ka qenë e paravendosur”*, dhe mendimi i Georgevit se; *“ndikimi grek është përfutur nëpërmjet bullgarishtes edhe mbi shqipen e rumanishten”*, bie në kundërshtim me faktin se prapavendosja e nyjës shquese në këto dy gjuhë është dukuri më e hershme se në bullgarishte e maqedonishte”. Hipoteza se, burimi i nyjës shquese në gjuhët ballkanike, duhet kërkuar në një nga gjuhët e vjetra të ballkanit, tek ilirishtja ose trakishtja përkatësisht te dakomizishtja, mbetet një hipotezë e pavërtetueshme pasi mungojnë dokumentet.

Mendimi i disa gjuhëtarëve për ndikimin e shqipes mbi rumanishten në shfaqjen e nyjës së prapme në atë gjuhë, mbetet një çështje e ndërlikuar. Nyja e prapme në rumanishte është përfutur pas shek VIII të e.r., po ashtu duhet të kemi parasysh edhe faktin se përfutimi i nyjës së prapme si në shqipe edhe në rumanishte, është rezultat i një procesi të shëndërrimit të shkallëshkallshëm të dëftorëve anaforikë të prapavendosur. Atëherë është më e arsyeshme të pranohet që shfaqja e nyjës së prapme është rezultat i një zhvillimi paralel. Por ajo që i dallon

këto dy gjuhë nga shumica e gjuhëve indoeuropiane të pajisura me nyje shquese, është prapavendosja e këtij mjeti gramatikor të shquarsisë.

5. Huazimet e shqipes nga gjuhë të tjera

Janë disa gjuhë fqinje dhe jo fqinje prej të cilave shqipja ka huazuar shumë fjalë. Këto huazime kanë ndodhur në periudha të ndryshme të zhvillimit historik, herë për shkak të pushtimeve, herë për shkak të shkëmbimeve e marrëdhënieve të ndryshme mes popujve. Gjuha shqipe ka disa huazime nga greqishtja, rumanishtja, turqishtja, latinishtja, italishtja. Kemi disa huazime nga greqishtja e vjetër p.sh.: greq. vj. *poneo*, shqip-punoj, greq. vj. *parakeo*, shqip *paraqes* (flijoj, i paraqes një dhuratë). Duke parë këto dy fjalë:

1. Ato kanë të njëjtën rrënjë indoeuropiane. 2. Janë huazuar nga greqishtja sepse në shqipe nuk ka evoluar kuptimi i fjalëve, kurse në greqishte vrojtohet evolucioni i fjalëve. Nga ana tjetër, huazimet e shqipes nga greqishtja e vjetër është një fakt që dëshmon lashtësinë e shqipes. Është një argument më tepër që mbështet autoktoninë e shqiptarëve. Pjesëza mohuese në greq. e vjetër: “uk” është huazuar dhe del sot në shqipen e vjetër “nuk”. Po kështu edhe pasthirrmat; *obobo*, *papapa* (Demiraj).

Fjalët me burim nga greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe janë huazimet më të hershme. Huazime të tilla hyjnë e krijohen edhe për shkaqe gjeografike, që në kohë më të hershme. Shumë fjalë greke hyjnë në shqipe që nga shek. VIII para epokës sonë. Në kohën kur kolonitë greke erdhën dhe u vendosën në trojet ilire, në *Epidamnos* (Durrës), *Pojan* (Apolono) etj. Fjalët nga greqishtja e vjetër u përkasin fushave shoqërore dhe të bimësisë si; *fier*, *lakër*, *mokër*, *pjepër*, *qershi*. Huazime leksikore nga greqishtja e kohës bizantine dhe të kohës së re kanë hyrë sidomos në jetën shoqërore, në artizanat, në botën artistike, në botën shtëpiake, kopshtari etj., si p.sh.: *avlli*, *fis*, *flamur*, *lajm*, *mëndafshi*, *i pastër*, *pronë*, *tipar*, *stolis*.

Një pjesë e madhe e huazimeve leksikore nga greqishtja kanë mbetur në të folmen anësore si krahinorizma; një pjesë tjetër ka dalë ose po nxjerr nga përdorimi fjalë të vjetëruara si:

historizma. Huazime leksikore nga greqishtja janë hasur më tepër në tevat jugore sesa në ato veriore, kjo për arsye të afërsisë gjeografike me viset jugore. Është dëshmuar gjithadhtu se dhe shqipja ka ndikuar mbi greqishten në greqishten. Në greqishten e re gjenden rreth 70 fjalë të burimit shqip (Tthomai, 257).

Huazimet e shqipes janë edhe fjalë që hyjnë nga latinishtja. Këto huazime janë kryesisht të periudhës bizantine, kohë e ndikimit dhe e studimit të Perandorisë Romake, e cila përhapi dhe gjuhën latine. Kryesisht huazimet vijnë nga latinishtja vulgare, p.sh.: fjala “simultaneus” e ka origjinën nga latinishtja, që nga viti 1652, me rrënjë fjalën “simul” dhe prapashtesa *taneus*. Sot kjo fjalë përdoret ‘simultan’ por shqipja e ka ‘simulant’ me një *t* fundore si mbaresë. Fjala lat. ‘amicus’, shqip ‘mik’ fjala lat. ‘cantare’, shqip *këndoj*. Huazimet latine i gjëmë përveç të tjerash, në sferën kishtarë më së shumti.

Huazime të rumanishtes në gjuhën shqipe. Ende nuk është e qartë çështja e djepit të rumunëve. Gjithsesi, rumanishtja klasifikohet si gjuhë romano -lindore. Shqipja dhe rumanishtja kanë afërsi të mëdha mes tyre. Duke iu referuar leksikut të këtyre dy gjuhëve ne njohim shumë fjalë të huazuara nga rumanishtja në shqipe, të cilat shoqërohen me shumë pak ndryshime fonetike. Përveç huazimeve nga gjuhët e tjera shqipja ka dhënë edhe ndikimin e saj në këto gjuhë; greqisht, gjuhët sllave dhe turqishtja kanë huazuar nga gjuha shqipe dhe në disa raste, disa fjalë i janë kthyer shqipes në një trajtë të ndryshme.

Përfundime

- Së pari, nyjat e prapme, nyjat e përparme të mbiemrave, të emrave, të përemrave, të numërorëve, nyjat e emrave në rasën gjinore nuk kanë kuptim leksikor, shprehin vetëm kuptime gramatikore dhe funksionojnë kështu në gjuhë për të dalluar fjalët ose për të formuar disa trajta fjalësh, njësoj si formantet gramatikore.
- Së dyti, po të pranohet se nyjat (i, e, të, së) janë pjesë ligjërare, atëherë duhet të pranohet se te mbiemri *i lartë* janë dy fjalë (1. *i* // 2. *Lartë*). Realisht, si nga pikëpamja kuptimore, ashtu edhe

gramatikore, pra(kuptimisht e gramatikisht) dimë se *i lartë* është një fjalë .

- Së treti, gjithashtu edhe struktura morfologjike e ndërtimeve të tilla vërteton se, kemi në këto raste një fjalë të vetme: e cila shfaqet në strukturën e vet analitike, për sa i takon strukturës morfologjike të fjalës. Kështu, mbiemri *i bardhë* lakohet duke ndryshuar vetëm nyjen e përparme (i), ashtu si lakohet *mur-i* duke ndryshuar vetëm “nyjen e prapme, mbaresën *i*.

- Ndryshe nga këto të ashtuquajtura “nyje me funksion pronori” (*i vëllaj, e motra, të vëllait, së motrës*), e cila ka kuptim leksikor, (atë të pronësisë, të të përkulturit), pasi shënon pronarin, sado që në mënyrë të zbehtë. Në të vërtetë, ajo është e njëvlershme me një trajtë të përemrit pronor (*i tij, e saj*).

- Nyjat janë morfema dhe morfema është njësi e kuptueshme, por a është njësi e ligjëratës? Këtu i referohemi kriterit gjuhësor sipas të cilit, që një fjalë të klasifikohet në këtë apo atë pjesë të ligjëratës duhet të përcaktohet dhe të përmbushë dy kriteret; kuptimin leksiko-kategorial dhe veçoritë e saj gramatikore.

- Nga gjithë sa parashtruam, duke u nisur nga fakti se si pjesë ligjëratare, jo gjithnjë duhet të gëzojë veçori gramatikore, si në rastin e lidhëzës, pjesëzës, pasthirmës, apo jo gjithnjë duhet të gëzojë kuptim të plotë leksikor e kategorial sin ë rastin e emrit apo të foljes, si dhe duke iu referuar faktit se është në gjendje të shërbejë si morfemë ndajshtesore trajtë e fjalëformuese, do të guxonim të ndërmernim pse jo dhe përdorimin e saj si pjesë ligjëratare.

Mendimet e shprehura nga gjuhëtarët dhe studiuesit për këtë çështje janë të ndryshme dhe

shpesh kontraktiktore, prandaj ende ky problem mbetet i paqartë. Përmendëm më sipër se kufijtë në gjuhë nuk egzistojnë për vetë faktin se gjuha gjithmonë evoluon, ndryshon, përsoset. Nga studime më të thelluara në të ardhmen, mendojmë se pozicioni dhe përdorimi i nyjës në strukturën e fjalisë në gjuhën shqipe, mund të marrë një tjetër interpretim.

Bibliografia

Çabej, E. (1977), Studime gjuhësore V. IV, Prishtinë.

Çabej, E. (1963), Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe, BSHSH 1963/3

Demiraj, Sh. (1986), Gramatika historike e gjuhës shqipe “Problemi i nyjave në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1986.

Demiraj, Sh. (2002), Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë.

Demiraj, Sh. (1988), Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë, 1988.

Demiraj, Sh. (2004), Gjuha ballkanike - prapavendosja e nyjës shquese, Tiranë.

Elezi, G. (2012), Gjurmime gjuhësore e interpretime të shqipes 1. “Probleme të nyjave në përmasat e mendimit të Çabejt si ndihmesë për çështje ende të pazgjidhura në gramatologjinë e shqipes”, Shkup.

Likaj, E. (1988), Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe – nyja dhe burimi i tyre, Tiranë.

Topalli, K. (2009), Nyjat e shqipes, Tiranë.

Thomai, J. (2006), Leksiologjia e gjuhës shqipe - disa njësi gjuhësore në kufij të fjalës; Huazimet e burimit grek, Tiranë..